



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

PRILL - QERSHOR 2021

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton numrin e dytë të revistës për vitin 2021, për periudhën prill-qershor.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, publikon 4 numra të newsletter-s me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një 'buletini' elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese/Info Day, Door to Door, AfterCare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmerr.

Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një 'dokumentim' që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve, një burimi informacioni që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.



AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos me përkrahjen e prodhuesve dhe produkteve vendase. Në funksion të një diplomacia ekonomike, jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objektiv promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.



Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj është një aspekt me prioritet të veçantë. Agjencia, veç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmerr nisja për rritjen e konkurrencës së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (NVM) zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, punon për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Gjithashtu, në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besues tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të brendit shqiptar.

Për të rejtat më të fundit mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve vizitoni:


 @aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  @investinalbania

 AIDA - Albanian Investment Development Agency

SHESHO KURBËN!

RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju kujton që duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm dhe të respektojmë masat parandaluese kundër COVID-19. Sot më shumë se çdo ditë ka nevojë për solidaritet.



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al
tel: +355 042 251 001
web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e investitorit strategjik, bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare.

Dokumentet e çfarëdollojshme përcillen përmes Postës Shqiptare, nëpërmjet adresës zyrtare të AIDA-s, info@aida.gov.al ose pranë zyrave të AIDA-s duke u lidhur më parë me stafin tonë.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale për përditësime.

AIDA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

AIDA shërben si një nyje lidhëse mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Qëllimi i saj është të ndërmarrë nisma të vazhdueshme që gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, biznese të zhvilluara, mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja në përputhje me profilin e burimeve dhe aspiratat e Shqipërisë.

AIDA është promotore e markës “Made in Albania”.

Në misionin e vet, vijon të mbështesë bizneset vendase duke zhvilluar sidomos sektorët prioritarë.

Gjatë vitit 2020 AIDA ka dhënë mbështetje konkrete ndaj biznesit vendas, ka ndikuar në thjeshtimin e procedurave për investitorët e huaj, vendosjen e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimin e informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimin e disa “out-reach campaign” në sektorët potencialë, realizimin e disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t’u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shënjon një strategji novatore, një vizion të ri në mënyrën e qasjes dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të Shqipërisë.



FUSHATA #EDUASHQIP NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE ‘MADE IN ALBANIA’

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera.

Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe foto të produktit.

Rrënjët janë të rëndësishme.

Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.



Veza "Beata"

Kompania "Beata" është themeluar në vitin 2009 në Koplik mes ajrit të pastër të fushës me Sherebalë dhe ujit të freskët që buron nga Bjeshkët në Malësinë e Koplikut. Kapaciteti i pularisë është 150.000 krenë pula prodhimi dhe 80 000 zoji për ritje. Vezët "Beata" janë produkt i pulave të shëndetëshme, të rritura me drithëra natyrale, pa ritës artificiale, të pasura me omega 3, proteina etj. Kompania "Beata" është e pajisur me numër CE për të drejtë eksporti të vezës të klasit B. Çdo produkt "Beata" analizohet në laboratorin Noval, i vetmi i akredituar në Shqipëri me standardet më të larta europiane. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@beata.al ose në 069 700 6030.



Kantina Bejko

Në mes të vreshtave të njohura të Piskovës, Përmet, kantina Bejko është konsoliduar tashmë në rrethin tregtar në të gjithë vendin nëpërmjet cilësisë dhe sasisë së prodhimit. Përpunimi i rrushtit, prodhimi i verës dhe ruajtja në kantine bëhet në kushte natyrale. Varietetet e rrushtit që përpunohen janë të grumbulluara në rrethin e Përmetit. Vëmendje më të madhe i është kushtuar verës "Debina e Bardhe", pasi varieteti i rrushtit nga ka dhe emrin kjo verë, është një kultivar autokton i zonës së Përmetit, por kantina ofron dhe llojet e tjera si "Shesh i Bardhë" dhe "Kallmet". E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kantina-bejko@gmail.com ose në 0685205107.



Shafraan – Victus Fed shpk

Victus Fed shpk nisi veprimtarinë në vitin 2013, kur pas disa viteve eksperimentimi vendos të përqendrojë aktivitetin e prodhimit të erëzës së shafraanit në krahinën e Dumresë, falë klimës dhe karakteristikave të veçanta të territorit të pasur me liqene. Cikli i prodhimit është dyvjeçar dhe çdo ndërhyrje në kultivimin e shafraanit bëhet vetëm me produkte organike. Për t'i ofruar sigurinë maksimale konsumatorit, kompania është certifikuar sipas standardit ndërkombëtar për sistemin e administrimit dhe sigurisë në sektorin agrorshqimor EN ISO 22000 : 2005. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: victusfed@gmail.com ose në 0697787144.



Produktet "Canaj"

Në bjeshkët e Malësisë së Madhe, Tamare, në një kllimë të pastër dhe të pasur me burime ujore, kompania "Canaj shpk" grumbullon dhe përpunon frutat e freskëta për të sjellë në treg lëngjet e frutave Belta dhe lëngjet për fëmijë PIUPIU. Me një fabrikë moderne, të ndërtuar me maleve, "Canaj shpk" kujdeset që lëngjet e frutave të jenë natyrale, pa ngjyres artificiale dhe të një cilësie të lartë. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@canaj.al ose në +355 22 700 010.



Punishtja "Ngota"

Punishtja "Ngota" që prej vitit 2010, fillimisht në Dibër dhe tani edhe në vende të tjera të Shqipërisë, sjell në treg produkte të përpunuara të bulmetit të prodhuara me qumësht organik dhe të përpunuara sipas standardeve dhe teknologjisë më të lartë. Produktet si djathi i bardhë, kackavalli, kosi, dhalli janë më të preferuarat dhe më të veçantët. "Ngota" është e certifikuar konform standardeve ISO 22000:2005 i cili dëshmon se janë marrë të gjitha masat mbi sigurinë ndaj rezeqeve të ushqimit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@ngota.al ose në 0682064690.



Medaur-Kantina Miqësia

Kantina Miqësia e vendosur në zonën e Zagores, në Malësinë e Madhe, një zonë me traditë të hershme në kultivimin e rrushtit Kallmet njihet për verërat e saj cilësore. Pastertia, ngjyra intansive dhe aroma e qendrueshme e kësaj vere rrjedh nga sipërfaqja ujore e Liqenit të Shkodrës në reflektimin e dritës duke ndikuar në optimizimin e temperaturës së nevojshme për kultivimin e rrushtit. Kantina përdor një ndërthurje mes tradicionales dhe teknologjisë për të prodhuar verën dhe rakinë e rrushtit. Kantina "Miqësia" prodhon verëra si: Kallmet, Chardonnay, Cabernet Sauvignon me standarde të larta të sigurisë. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@medaur.com ose në 0682025943.



"Zojat e Munellës"

Mbështetur në traditën lokale të kultivimit, grumbullimit dhe përpunimit të frutave të ëgra, grupi i grave të shoqatës "Zojat e Munellës" nga fshati Kimez, në Pukë ofron lëngun e mrekullueshëm dhe të veçantë të manaferrës. Pasioni dhe përpjekjet për të përsosur zanatin e tyre u ka lejuar 'Zojave të Munellës' të sigurojnë produkte me vlera dhe me shije të cilat i qëndrojnë besnike origjinës së tyre malore. Lëngu i manaferrës ka veti të shquara kurative, për shkak të nivelit të lartë të vitaminës C që përmban.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: lediprenga21@gmail.com ose në 069 283 6082.



Produktet "Premti"

Kompania Premti është themeluar në vitin 2016 dhe në fokus ka pasur gjithmonë prodhimin dhe tregtimin e produkteve tradicionale të zonës së Përmetit duke i qëndruar besnik traditës.

Ata përpunojnë frutat e shëndetshme, pasi i zgjedhin kokërr më kokërr. "Premti" sjell produkte cilësore, të sigurta dhe plot me shije si: gliko arze, fiku, kumbulle, portokalli, shalqini etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@premti.al ose në 069 637 1310.



Produktet "ERVISI"

Fabrika e përpunimit të qumështit "ERVISI" me vendodhje në Shkodër, ka nisur si një biznes familjar ku me kalimin e viteve ka ardhur duke zgjeruar gamën e produkteve si dhe tregun që mbulon. Kompania prodhon kryesisht produkte me qumësht llope, siç janë: djathë i bardhë, djathë kaçavall, kos, gjalpë, gjizë dhe dhallë. Qëllimi i fabrikës "ERVISI" është t'u ofroj konsumatorëve produkte BIO dhe të sigurta.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: ldrizishqipnja@yahoo.com ose në 067 288 9459.



Kantina "Vreshti i Pashait"

Në luginën e Sarandaporit, biodiversiteti i veçantë i Leskovikut mundëson ritjen e varieteteve të ndryshme të luleve të ëgra, të cilat ndikojnë në shijen dhe aromën dehëse të verës së prodhuar nga kantina "Vreshti i Pashait". Kantina ka fituar çmimin e argjendtë në Ballkan, për vitin 2020, me 'Cabernet Sauvignon'. Një verë e thatë, plot karakter, shije, e vjetruar në bute druri dhe përpunuar në mënyrë natyrale dhe cilësore ajo është e pazëvendësueshme. Gjithashtu, 'Vreshti i Pashait' prodhon verën 'Riesling', 'Chardonnay', 'Shiraz' dhe 'Merlot'.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: albertgajo@hotmail.com ose 0672022773



Produktet "Dalmacia"

Në zonën e Dalmacisë, në Pukë, kompania Dalmacia Sh.P.K. grumbullon dhe përpunon fruta në mënyrë natyrale që prej vitit 2008. Janë të specializuar në përpunimin e frutit të thanës dhe frutave të tjera të pyllit, si: boronicë, manaferrë, mjedër, dredhez, dëllinjë.

Në laboratorin e kësaj kompanie prodhohen lëngje frutash, suko, komposto, shurup, raki, liker dhe marmalata organike të certifikuara.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: dalmacia_puke@hotmail.com ose +355 (0)68 349 1202



Produktet Mireli

Fabrika e qumështit 'Mireli', u themelua dhe nisi aktivitetin në prodhimin e qumështit dhe në produkteve të tij, në vitin 1992. Kompania ka realizuar investime të mëdha teknologjike ndër vite për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese. Fabrika e qumështit 'Mireli', është një ndër liderat e tregut shqiptar, të prodhimeve të qumështit, djathërave, kosit etj. Produktet e ofruara prej saj, janë të një cilësie tepër të lartë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kontakt@mireli.al ose në +355 68 406 60 04.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Zepa Natyral

"Zepa Natyral" është kompania e parë Shqiptare me fokus 100% në cilësinë e prodhimit të qumështit, nënprodukteve të tij dhe lëngjeve të frutave.

E lançuar për herë të parë në vitin 2017 sjell në treg produkte me siguri ushqimore, paketim të standartuar, testime dhe analiza të vazhdueshme. Produktet "Zepa Natyral" ofrojnë një cilësi të lartë të lëndës së parë, duke u kujdesur në ritjen e besueshmërisë së konsumatorit ndaj prodhimeve "Made in Albania".

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@zepanatyral.al ose në 069 7070 123.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Sejega

Kompania Sejega u themelua në vitin 1994 si një sipërmarrje modeste private. Cilësia e prodhimit dhe besimi i konsumatorëve e kanë inkurajuar kompaninë të krijojë linja të reja prodhimi, siç janë ato të konservimit të fruta perimeve, reçelrat e llojeve të ndryshëm, kompostot dhe marinadat tradicionale e deri tek përpunimi dhe konservimi i kërpuchave. Produktet "Sejega" njihen dhe konsumohen jo vetëm në tregun vendas por edhe atë ndërkombëtar, siç është majoneza "Made in Albania" që po shëtit botën.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@sejega.com ose në 069 4032 313.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Produktet KMY

"KMY shpk" është themeluar në 1997, si një kompani shqiptare e përpunimit të mishit në Tiranë. Aktiviteti i tyre konsiston në: transportin e produkteve ushqimore, produkteve të freskëta dhe të ngrira të mishit në shumë supermarkete në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, ata disponojnë thertoren e vetme në Shqipëri për mishin e derit dhe mishin e vicit si dhe fabrikën për përpunimin e mishit të freskët. Produktet e shijshme që "KMY shpk" prodhon janë: kremviçe të tymosura, proshutë, sallam etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kmy.al ose në 0689027049.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



"Stone City Soap"

Gjatë pandemisë, kur fjalët që dëgjoheshin më shpesh ishin kujdesi për higjienën personale me kryefjalë larjen e duarve, Jonida Çuberi në qytetin e Gjirokastrës filloi punën për krijimin e sapunëve me përbërës organikë. Lëndët e para të përdorura janë produktet bimore, si: kafa, xhelli aloe vera, çaj i mallit, rozmarina apo produkte të dyqaneve lokale të zonës. Vajrat esenciale janë të standardëve ISO9001, ISO 14001 & 18001. Edhe pse në një kohë mjaft të shkurtër, "Stone City Soap", ofron sot në treg 16 lloje sapunësh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: jonida_dhrami@yahoo.com ose në 069 4422 978

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Veza "Butrinti"

Në fshatin Kukë, Sarandë, në një pozicion gjeografik mjaft të favorshëm agrikulturnë, me një klimë mesdhetare me mbi 300 ditë diell në vit, në fermën Butrinti prodhohen vezët "Butrinti".

Nga pula që ushqehen dhe rriten në natyrë, pa marrë antibiotikë prodhohen vezët organike dhe pa pesticide. Vezët përmbajnë të gjithë 9 aminoacidet thelbësore dhe 14 lëndët ushqyese kryesore.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: vezebutrinti@gmail.com ose në 069 851 1625.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



"Dhiamandi Glass"

"Dhiamandi Glass" është një studio artisanale, e themeluar nga artisti Vasil Dhiamandi në vitin 2006, që ofron produkte artistike të punuara me qelq. Teknikat e realizimit janë vitrazhi dhe pjekja. Disa prej sendeve të "Dhiamandi Glass" janë edhe enët e kuzhinës prej qelqi. Enët prej qelqi me stil modern janë të përshatshme për dhuratë dhe përdorim personal. Pigmentet e ngjyrave janë të sigurta për produktet ushqimore dhe rezistente për larje në temperatura të larta.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: dhiamandiglass@gmail.com ose në 069 5115 892

AIDA përklrah prodhuesit shqiptarë



Kantina "Korça 2000"

Kantina "Korça 2000" sh.p.k është themeluar në vitin 2000 në qytetin e Korçës. Me një eksperiencë 18-vjeçare paraqitet në treg me produkte cilësore dhe konkurruese. Varietetet e rrushit që përpunohen janë: kabëmet, mavrud, shesh i zi, merlot, riesling, si dhe varietetet autoktonë të zonës së Korçës: serini i zi, serini i bardhë, perla. Produktet e "Korça 2000" si ferneti, vera, rakia, brandy dhe likeri janë të pajisura me certifikatën e sigurisë ushqimore ISO 22000:2005.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@korca2000.al ose në 068 6073 210

AIDA përklrah prodhuesit shqiptarë



"Djathë Veleçiku"

"Djathë Veleçiku" është një sipërmanje familjare e vendosur në fshatin Hot të Malësisë së Madhe që po njih zhvillim të pandërprerë me produkte të veçanta e cilësore, që ndërthurin traditën e përpunimit me shijen e rafinuar nga erëza të veçanta. Djathi është i prodhur nga qumështi i bagëtive të cilat kullojnë në beshkët e Kelmendit. Cilësia e lartë e këtyre kullotave e ndërthurur me teknologjinë holandeze jep një cilësi të pakrah-sueshme me asnjë lloj tjetër djathi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 069 4675 505 ose në: gjovi2009@hotmail.com

AIDA përklrah prodhuesit shqiptarë



Kantina "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"

Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" ndodhet në Kodrën e Rashbullit dhe shtrihet në një sipërfaqe afro 45,000 m2. Prodhimet e kantinës janë rreth 13 lloje vererash si psh: Primitivo, Chardonnay, Riesling, Merlot, Shesh i Zi etj. Gjithashtu, kantina prodhon dhe pije të tjera alkooolike si: Skënderbeu Brandy, Bato Brandy, Raki Moskat, Raki Rrushi, Fernet, Pong Portokalli, likera të ndryshme si dhe Uthull Balsamico. Produktet e kantinës janë vlerësuar disa herë me çmime në konkurse kombëtare dhe ndërkombetare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kantinaskenderbeu.al ose në 068 201 1733.

AIDA përklrah prodhuesit shqiptarë



Produktet "Bonum"

Ferma "Bonum" u krijua në vitin 2015, ndërkohë marka "Bonum" u komercializua në vitin 2020.

Bonum është një ndër fermat më të mëdha në vend për mbarëshkrimin e dhive, si dhe një furnizues i qumështit të dhisë për kompani të tjera që operojnë në Shqipëri. Veçantia e bulmetit Bonum është tek prodhimi "çdo gjë brenda fermës", me cikël të plotë, që nga ushqimi i dhive, deri te produkti final. Kjo mundëson kontrollin mbi të gjithë zinxhirin ushqimor, si edhe ruajtjen e standardit që synohet.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: asadushi@fermaeshijes.al ose në 069 605 0506.

AIDA përklrah prodhuesit shqiptarë



Kantina "ALBANICA"

Kantina "Albanica" është vendosur në kodrat e Ardenicës, në Fier. Vera "Albanica" është prodhimi unik i një territori historik të rrahur nga flladit i Mesdheut. Mbatja e lagështisë dhe lëndët ushqyese të pasura, e bëjnë tokën ideale për kultivimin e rrushit Cabernet Sauvignon dhe Merlot për rezultatit e verës së cilësia më të lartë.

Vera "Albanica" ka një ngjyrë të errët rubini, me aromë qershie vishnje dhe fruta pylli.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@albanicawine.com ose në 069 489 1200.

AIDA përklrah prodhuesit shqiptarë



Reçi BioFarm

Reçi BioFarm është një punishte moderne për përpunimin e qumështit dhe djathit të dhisë.

E krijuar në vitin 2012, në zonën e Kraj Recit, pjesë e rrethit të Dibrës, Reçi BioFarm ofron për konsumatorët një produkt të shëndetshëm dhe bio.

Qumështi i dhisë mblihet nga të gjithë fshatarët e zonës dhe ruhet sipas standardeve europiane për të përfutur një produkt cilësor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@biofarm.al ose në 068 400 7110.

AIDA përkrah prodhuesit shqiptarë



Vaj Ulliri "Suli"

Vaji i ullirit Ekstra i Virgjër Suli është prodhuar 100% nga ullinj të varietetit Kalinjot, të rritur në kodrat e Himarës, afër detit Jonian.

Vaji përftohet para se ullinjtë të kenë arritur pjekurinë maksimale dhe shtypen vetëm përmes proceseve mekanike.

Në përfitim e vajt të ullirit Suli, nuk përdoret nxehtësi, por prodhohet me anë të shtypjes së ftohtë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: oliveoilsuli@gmail.com ose në 069 387 7939.

AIDA përkrah prodhuesit shqiptarë



Vaj Ulliri "Shkalla"

Fabrika e prodhimit të vajt të ullirit të firmës 'Shkalla' ndodhet në Lundër, 6 km larg qendrës së Tiranës.

Me një eksperiencë 14-vjeçare në fushën e prodhimit të vajt të ullirit, kompania Shkalla Sh., mund të quhet lider në këtë fushë. Në sajë të përpjekjeve të vazhdueshme dhe me asistencën e donatorëve të huaj Shkalla Sh., sot eksporton vaj ulliri organik ekstra të virgjër në Zvicër, si dhe prodhon për tregun vendas.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@shpresashkalla.com ose 067 206 8924.

AKSES NË FINANCË PLATFORMA UNIKE PËR FINANCIMIN E BIZNESEVE

Akses në Financë” është platforma më e re në vend që i dedikohet informimit të biznesit mbi burimet financiare. Dritarja unike, “Akses në Financë”, lindi si bashkërendim prioritetesh mes AIDA-s, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe mbështetjes së Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Platforma, si një instrument i rëndësishëm elektronik, u krijua për të qenë pika e parë e referimit dhe e qasjes nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme shqiptare, pasi ajo unifikon të gjithë informacionin mbi aksesin në financë, mundësitë financiare që tregu ofron, me grante, kredi dhe nisma të tjera financuese nga donatorë të sektorit privat dhe publik.

Sipërmarrës dhe individë me nje ide biznesi, përmes këtij instrumenti të centralizuar, marrin në kohë reale të gjithë njoftimet mbi skemat financiare më të fundit, për çdo lloj SME-je dhe çdo sektor që ofrohet nga institucionet shtetërore, donatorë vendas dhe ndërkombëtarë.

“Akses në Financë” ofron shërbimin “one-stop-shop” me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë, ku skemat financiare që publikohen në platformë janë të aksesueshëm për të gjithë NVM-t, kompanitë Start-Up, mikrokopanit apo dhe individët me ide biznesi.



THIRRJE TË REJA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mirëmban dhe përditëson me skema të reja financiare platformën “Akses në Financë”, duke ofruar informacionin më të fundit mbi mundësit e burimet financiare për NVM-të në Shqipëri. AIDA kujdeset që thirrjet e publikuar në platformë <https://aida-smefinance.gov.al/> të përmbajnë të dhënat thelbësore dhe të jenë shteruese në përcjelljen e informacionit për të orientuar një aplikim të suksesshëm dhe për të përmbushur në këtë mënyrë misionin që ka në mbështetje të biznesit vendas.

DIGIFED-DIGITAL CHALLENGE

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime për ‘Digifed-Digital Challenge’, i cili është aktiviteti më i madh online për startup-et dhe NVM-të, të cilët janë të gatshëm të: a) përgjigjen ndaj sfidave digjitale për të cilat nuk janë identifikuar në treg ‘sisteme fizike cyber’; b) bashkëpunojnë me organizata të mëdha për të gjetur zgjidhjet e mundshme. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/digifed-digital-challenge-open-call-2>



EIC TRANSITION

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime për ‘EIC Transition’, e cila financon projektet që zhvillojnë teknologjinë dhe inovacionin në ndihmë të komercializimit të tregut. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/eic-transition>



CAPACITY BUILDING IN THE FIELD OF YOUTH (ERASMUS-YOUTH-2021)

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime për ‘Capacity Building In The Field Of Youth (Erasmus-Youth-2021)’, e cila ka si objektiv promovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të organizatave që punojnë me të rinjtë. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/capacity-building-in-the-field-of-youth-erasmus-youth-2021>



IPA III CROSSBORDER PROGRAMME ALBANIA-KOSOVO

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime për 'IPA III Crossborder Programme Albania-Kosovo', e cila ka si objektiv inkurajimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Vizitoni platformën Akses në Financë:


<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/cross-border-programme-albania-kosovo-2014-2020-priority-2-encouraging-tourism-and-cultural-and-natural-heritage>



CEE STARTUP CHALLENGE

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime për 'CEE Startup Challenge', i cili është aktiviteti më i madh online për startup-et në Evropën Qendrore dhe Lindore. Vizitoni platformën Akses në Financë:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/cee-startup-challenge>



AIDA, BERZH DHE AZHBR INFORMOJNË BIZNESIN

AIDA, BERZH dhe AZHBR si institucione që kanë në fokus kryesor mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Shqipëri, për t'i ndihmuar ato që të rriten, të zgjerojnë aktivitetin, të kenë qasje më të madhe në financim dhe të jenë më konkurruese, jo vetëm në tregjet rajonale, por dhe në ato ndërkombëtare, ndërmorën një nismë për të informuar biznesin në qarkun e Beratit.

Një 'Info Day' për bizneset e vogla dhe të mesme të qarkut të Beratit, e iniciuar nga AIDA, synoi që së bashku me aktorët e biznesit në këtë qark, të mbahej një takim informuese mbi shërbimet, aksesin në financë, zgjerimin në tregje jashtë vendit, mbështetjen e AIDA-s, Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të ekosistemit të biznesit.

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano, prezantoi shërbimet e Agjencisë, për rritjen e konkurrueshmërisë, zgjerimin e tregut dhe zhvillimin më tej të bizneseve shqiptare. Z. Nano theksoi se AIDA do të vijojë të ndër-marrë nisma të tilla informuese edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, kjo për të qenë sa më pranë biznesit dhe për përmbushjen e objektivave që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e sipërmarrjes vendase.

Në takim, Kryetar i Bashkisë Berat, z. Ervin Demo, përshëndeti nismën dhe ftoi bizneset e qarkut të aplikojnë dhe përfitojnë nga mundësitë e shumta mbështetëse; Drejtore e AZHBR, znj. Frida Krifca, theksoi vëmendjen e veçantë të Qeverisë në mbështetje të sipërmarrjeve të



vogla dhe të mesme me investime në asete fizike për të gjeneruar ekonomi qarkulluese në mjedisin rural dhe në emër të BERZH, znj. Adriola Hristic, prezantoi nismat financiare të Bankës për zhvillimin e biznesit inovativ dhe të qëndrueshëm.

AIDA në këtë aktivitet të përbashkët vuri theksin edhe një herë mbi rëndësinë dhe gatishmërinë e vet si një pikë kyçe për të vijuar mbështetjen e biznesit vendas me asistencë teknike dhe financiare, ku sidomos organizimi dhe pjesëmarrja e biznesit në evente të kësaj natyre janë mundësi frytdhënëse dhe tepër të domosdoshme për të bashkëbiseduar, për t'u informuar, si edhe për të qenë në kontakt direkt me institucione që aplikojnë politika të dedikuara për zhvillimin e bizneseve. Bizneset e pranishme u informuan dhe asistuan gjithashtu se si të bëhen pjesë e Rrjetit European të Ndërmarrjeve.



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për realizimin e këtij eventi informues bashkëpunoi me Bankën Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bashkinë e Berat, Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), CEFE International, CoSolve (Projekt i Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar -GIZ).

AIDA NË TAKIME DYPALËSHE



AIDA vijon të ndjekë politika për të thelluar marrëdhëniet bilaterale diplomatike, tregtare për promovimin e vendit, mbështetjen dhe nxitjen e partneriteve të NVM-ve, tërheqjen e investimeve, si dhe për të rritur shkëmbimet ekonomike, tregtare, kulturore etj.

SHQIPËRIA NJË DESTINACION KYÇ PËR INVESTIMET JAPONEZE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, z. Sokol Nano priti në takim Ambasadorin e Japonisë në Shqipëri, Sh. T. Z. Takada Mitsuyuki dhe z. Izumi Akihiro, Këshilltar pranë Ambasadës.

Ky takim kishte në fokus prezantimin e potencialeve të Shqipërisë



Shqipërisë si një destinacion kyç për investimet japoneze në Ballkanin Perëndimor.

Z. Nano dhe Sh. T. Z. Mitsuyuki ranë dakord se duhet një bashkërendim i mirë punësh dhe forcash për të arritur në rezultate konkrete investimesh.

U dakordësua në parim që së shpejti të organizohen aktivitete të përbashkëta për prezantime direkte me kompanitë japoneze dhe ato shqiptare.

AIDA DHE AMBASADA E AUSTRIËSË NË TIRANË FORCOJNË BASHKËPUNIMIN

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, z. Sokol Nano së bashku me Drejtoreshën e Investimeve, znj. Mileva Meksi pritën në një takim Ambasadorin e Austrisë në Shqipëri, Sh. T. Z. Christian Steiner dhe Drejtoreshën e zyrës Advantage Austri Shqipëri, znj. Marlinda Zotaj.

Z. Nano dhe Sh. T. Z. Steiner, gjatë këtij takimi të përbashkët, rikonfirmuan edhe një herë marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale midis dy vendeve.

Në bisedë u këmbyen mendime mbi çështje me interes të përbashkët, u theksua forcimi i bashkëpunimit, gjithashtu u shpreh gatishmëria për të vijuar mbështetjen e sipërmarrjes vendase dhe austriake, perspektivat e së ardhmes për të krijuar partneritet, për të tërhequr dhe sjellë investime të reja, si edhe organizimin e eventeve me agjendë të përbashkët.



AIDA DHE SHOQATA PRO-EKSPORT ALBANIA NË MBËSHTETJE TË BIZNESIT VENDAS DHE EKPORTEVE

AIDA priti në takim pranë zyrave të saj një përfaqësi nga Shoqata Pro-Eksport Albania. Z. Sokol Nano, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve dhe z. Edvin Prençe, Kryetar i Shoqatës Pro-Eksport diskutuan në terma konkret për mbështetjen e biznesit dhe eksporteve në vazhdimësi.

Nga të dyja palët u shpreh dakordësia në mendimin se kompanitë shqiptare janë në një fazë shumë të mirë zhvillimi dhe konkurruese në rajon dhe më gjerë. Prodhimet me cikle të plota dhe të përfunduara të cilave janë tanimë një markë besimi.



TAKIME DHE VIZITA



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve në kuadër të monitorimit të fondeve, prezantimit dhe informimit mbi shërbimet EEN-Albania, zhvilloi takime Door to Door në biznesin “Konserva Vlora”, kompaninë “Sejega SH.P.K”, kantina “Bardha”, “Keli Albania”, “Natyral&ATC” dhe në ambientet e biznesit “LEA 2011”.

“KONSERVA VLORA”

“Konserva Vlora”, biznes i themeluar në vitin 2010, është i specializuar për përpunimin e sardeles duke e konservuar në ambalazh të tipit alumin. Furnitorët kryesorë të peshkut sardele janë nga qyteti i Vlorës dhe Durrësit. Në takim përfaqësuesi i kompanisë, z. Saimir Hoxhaj, shprehu interesin për mundësitë e eksportit, bashkëpunimin me AIDA-n për përfitimin e fondeve që ofron, si dhe promovimin e produktit në fushatën ‘Zgjidh të Vendi’. Gjithashtu, u diskutua edhe sesi Enterprise Europe Network - Albania mund t’i përgjigjet nevojave të subjektit, duke përgatitur profilin dhe identifikuar partnerë ndërkombëtarë, si hapi i parë drejt eksporteve.



“SEJEGA SH.P.K”

“Sejega SH.P.K”, është themeluar në vitin 1994 në Tiranë si një biznes familjar. Kompania operon në sektorin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore. Rritja e kërkesave të konsumatorëve dhe shtrirja e rrjetit bëri të domosdoshëm krijimin e linjave të reja prodhimit, siç janë ato të konservimit të fruta perimeve, reçelrat e llojeve të ndryshëm, kompostot dhe marinadat tradicionale e deri tek përpunimi dhe konservimi i kërpudhave. Në vitin 2019 kompania ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë i AIDA-s, të cilin e ka përdorur për konsulencë dhe certifikim ISO. Përfitimi i grantit ka ndihmuar kompaninë të jetë më konkurruese në tregun vendas e të huaj, duke rritur cilësinë e prodhimit dhe vlerën e shtuar të punës.



"LEA 2011 SHPK"

LEA 2011 SHPK, është themeluar në vitin 2010 dhe ka si aktivitet import-eksportin e fruta perimeve. Në vitin 2019, kompania ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë i AIDA-s, të cilin e ka përdorur për konsulencë dhe certifikim ISO. Ky certifikim e ka ndihmuar kompaninë të jetë më konkurruese në tregun ndërkombëtar, duke rritur besueshmërinë e produktit. Përfaqësuesi i kompanisë z. Citozi, u shpreh se certifikimet kishin bërë të mundur rritjen e kërkesës nga partnerët ekzistues, si edhe rritjen e numrit të klientëve të rinj. Aktualisht, kompania eksportonte 90 % të prodhimit në tre shtete, Itali, Hungari dhe Slloveni.



“NATYRAL & ATC”

“Natyral & ATC”, është themeluar në vitin 1992 në Shkozë, Durrës. Aktiviteti kryesor i “Natyral & ATC” është tregtimi me shumicë dhe pakicë, grumbullimi, përpunimi i bimëve aromatiko-mjekësore, çajrave, erëzave dhe esencave. Produktet e kompanisë tregtohen në Shqipëri dhe Kosovë në supermarkete, bare restorante e farmaci. Kompania eksporton bimë aromatiko-mjekësore dhe çajra në Amerikë, Japoni, Kinë, Hungari, Bullgari, Kosovë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Në vitin 2019, kompania ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë i AIDA-s, të cilin e ka përdorur për ambalazhim produkte. Përfitimi i grantit ka rritur vlerën e shtuar të punës.



KANTINA “BARDHA”

Kantina “Bardha”, ka filluar aktivitetin në vitin 2006, duke prodhuar verë 100% shqiptare. Në vreshtari kultivohen katër lloje varietetesh rrushi autentike shqiptare, si: Mavrud, Shesh, Merlot dhe Debinë. Kantina “Bardha” ndërthur teknikat moderne të prodhimit të verës me traditat e lashta të vreshtarisë, duke prodhuar një produkt të një cilësie të lartë ‘Made in Albania’. Vera e kantinës “Bardha” është vlerësuar edhe me disa çmime në konkurse të ndryshme ndërkombëtare. Në vitin 2019, kantina “Bardha” ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë, të cilin e ka përdorur për ambalazhime të reja për produktet e verës. Përfaqësuesit e AIDA-s shpjeguan sesi EEN mund t’i përgjigjet nevojave të reja të subjektit, duke përgatitur profilin dhe identifikuar partnerë ndërkombëtarë.



“KELI ALBANIA”

“Keli Albania”, operon në treg që prej vitit 2013 në sektorin e prodhimit të duraluminit. Produktet kryesore që kompania prodhon janë: dyer dhe dritare plastike, dyer dhe dritare alumini termik, qepena alumini, grila taparel dhe grila persiane. Në vitin 2019 subjekti ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë i AIDA-s, të cilin e ka përdorur për konsulentë dhe certifikim ISO. Përfitimi i grantit e ka ndihmuar biznesin të jetë më konkurrues në treg, duke rritur cilësinë e prodhimit dhe lidhjen e kontratave të reja për eksport. Cjatë takimit u shpjegua se si rrjeti Enterprise Europe Network - Albania mund t’i përgjigjet nevojave të subjektit, për të bërë identifikimin e partnerëve të rinj ndërkombëtarë me qëllim eksportin.



AFTERCARE KUJDESI PËR BIZNESIN



AIDA ZGJERON RRJETIN AFTERCARE DHE MBËSHTET INVESTIMET NË VEND

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve gjatë tremujorit të dytë të vitin 2021 vijoi punën së bashku me partnerët vendorë, për t'i ofruar investitorëve ekzistues mbështetje gjithëpërfshirëse, jo vetëm në përkrahjen e riinvestimeve në zonë, por dhe në promovimin e resurseve. Nisur nga impakti i lartë dhe frytdhënës i programit “Investment Promotion & AfterCare”, ku bashkitë konsiderohen si aktorë kyç në punën e AIDA-s kundrejt biznesit, vijoi zgjerimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore. Shërbimi AfterCare pranë AIDA-s gjatë kësaj periudhe vazhdoi zbatimin e projektit të ndërmarrë në partneritet me GIZ, me takime të njëpasnjëshme në Bashkinë e Kavajës dhe në atë të Vorës, duke theksuar në këtë mënyrë rëndësinë që kanë në krijimin e një klime të përshtatshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve vendore. Qëllimi i këtyre vizitave lidhej me krijimin e bashkëpunimeve që kanë në fokus trajtimin e disa çështjeve, si: ndikimi i Covid-19 ndaj biznesit, planet e zhvillimit, lehtësimi i bashkëveprimit me autoritetet vendore në ndihmë të punësismit, shfrytëzimi i resurseve lokale, si dhe diskutimi i nevojave të ndryshme të biznesit. Pas secilit takimi, AIDA vijon me ndjekjen e problematikave dhe përcjelljen e tyre në institucionet përgjegjëse, me synimin e përmbushjes së objektivit kryesor të këtij projekti, krijimin e një klime të favorshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve në nivel vendor.

AIDA TAKIME TË KUJDESIT NDAJ BIZNESIT NË KAVAJË DHE VORË

“ALER GROUP”, “ELSED” & “DUPI-FRUT”

- Shërbimi AfterCare pranë AIDA-s zhvilloi disa vizita në biznese që operojnë në zonën e Bashkisë Kavajë, në sektorë të ndryshëm, si: “Aler Group”, “ELSED” dhe “Dupi-Frut”. Prioritetit kryesor ka qenë konsolidimi i bashkëpunimit midis AIDA-s, bizneseve dhe qeverisjes lokale, si dhe diskutimi i nevojave apo problematikave të ndryshme që kanë hasur dhe për të cilat kërkojnë mbështetje. Gjatë takimeve kanë dalë disa propozime, duke u shqyrtuar mundësia e lehtësimit të barrës fiskale nga qeverisja vendore, për bizneset të cilat shprehen të gatshme të marrin nxënës të shkollave profesionale për praktikë mësimore. Gjithashtu, u diskutua nga bizneset edhe mundësia e përfshirjes së kurrikulave të reja në shkollat profesionale, për të krijuar një përqsasje tjetër, ku të përshtatet nevoja e tregut me përgatitjen specifike që marrin nxënësit në këto shkolla.



“BUJTINA AJAZI”

“Bujtina Ajazi”- Sektori i Investimeve & AfterCare i AIDA-s zhvilloi një takimi në “Bujtina Ajazi”, me synimin për të konsoliduar bashkëpunimin ndërmjet AIDA-s, qeverisjes lokale dhe shkollave profesionale, ku u diskutua edhe për nevojat e problematikave të ndryshme të hasura. Një nga çështjet që kërkohet mbështetja e shtetit është infrastruktura rrugore, pasi ky restorant ndodhet në një zonë rurale, me akses relativisht të vështirë që mund të ndikojë në frekuentimin dhe ecurin e tij. Bujtina, si një investim



i ri, tanimë prej dy muajsh ushtron aktivitetin e saj në sektorin e agroturizmit dhe numëron 12 të punësuar.

Subjekti shprehu gatishmërinë për të marrë nxënës, me profil në agroturizëm, nga shkolla e mesme profesionale “Charles Telford Erikson”, për të zhvilluar praktikën mësimore.

“FLOWER HOTEL & SPA”

“Flower Hotel & Spa”- AIDA, si pjesë të nismës dhe shërbimeve AfterCare, zhvilloi vizitën e radhës në “Flower Hotel & Spa”, një biznes që operon prej 2016 në sektorin e turizmit. Ky investim në bregdetin e Golemit, një shembull suksesi në Shqipëri, është në proces e sipër për një riinvestim në po të njëjtën zonë dhe nën siglën “Flower Hotel & Spa”.

AIDA në kooperim me qeverisjen vendore ndjek problematikat e shprehura nga biznesi, me synimin për të përmirësuar shërbimin e transportit publik në këtë zonë. Subjekti shprehu disponueshmërinë për të vazhduar më tej marrjen e nxënësve me arsim dhe formim profesional për praktika mësimore, sipas kurrikulave përkatëse. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve në këtë takim u përfaqësua nga ekipi i Sektorit të Investimeve & AfterCare.



“SAINT-GOBAIN”

“Saint-Gobain” - Shërbimi AfterCare pas përmbylljes së vizitave të realizuara në bashkinë e Kavajës, ka vazhduar vizitat në disa biznese në bashkinë Vorë. Vizita e parë u zhvillua në kompaninë franceze “Saint-Gobain”, e cila ushtron aktivitetin në sektorin e ndërtimit prej qershorit të vitit 2016 pasi bleu fabrikën ‘Ital-Col’. Portofoli i ‘Saint-Gobain’ përfshin të gjithë materialet e ndërtimit. Kompania ka sjellë në tregun shqiptar një nga korporatat më të mëdha në botë, me histori 360 vjeçare dhe ekspertizë ndërkombëtare në fushën e ndërtimit.




“KÜNZLI FACTORY”

“Künzli Factory” - Subjekti i radhës që stafi i Sektorit të Investimeve dhe AfterCare vizitoi ishte “Künzli Factory”, i cili ushtron aktivitetin prej vitit 2018 në fushën e prodhimit të këpucëve, të specializuara për probleme ortopedike dhe shëndetësore. Kompania me kapital 100% zviceran ka të punësuar 24 punonjës, të specializuar në punë artizanale. Në mënyrë artizanale, prodhohen 45-50 palë këpucë në ditë që eksportohen, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër.



“RENOVA”

“RENOVA” - Në vijim të zgjerimit të rrjetit të bashkëpunimit të AIDA-s me dy bashki të reja, Sektori AfterCare, në partneritet me GIZ Albania, zhvilloi një takim pranë kompanisë RENOVA, në Bashkinë e Vorës. Kompania maqedonase operon në tregun shqiptar prej vitit 2007. RENOVA ka fabrika në Kosovë dhe Mal të Zi, dhe është lider në cilësinë e prodhimit të materialeve të ndërtimit në tregun mbarëshqiptar. Subjekti ka përfituar prej skemës së rimbursimit të TVSH-së nga Qeveria Shqiptare, çka e ka ndihmuar në përballimin e kostove.



“TIRANA BUSINESS PARK”

“Tirana Business Park” - Takimi i radhës u zhvillua në Tirana Business Park, pjesë e Lindner Group, një investim i madh gjerman që ushtron aktivitetin e tij në sektorin imobiliar prej vitit 2008. Së shpejti, projekti i Tirana Business Park, vjen i rikonceptuar me një plan për të krijuar qytet brenda qytetit me zona banimi, argëtimi, edukimi dhe peizazhe. Ky projekt i ri do të sjellë për herë të parë në Shqipëri brendin mk|hotels. Hapja e hotelit me 5 yje mk|hotel parashikohet gjatë verës së 2021.



Business Support on Your Doorstep

ENTERPRISE EUROPE NETWORK–ALBANIA (EEN-ALBANIA)

AIDA & EEN-ALBANIA NË TAKIMIN RAJONAL QË U MBAJT NË KOSOVË PËR SIPËRMARRJET E SEKTORIT ICT

AIDA dhe EEN-Albania në cilësinë e bashkorganizatorit morën pjesë në “PrishtinaMatch4ICT”, një event biznesi dyditor për sektorin e ICT, për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky takim mbledhi bashkë sipërmarrje nga rajoni, të cilat operojnë në sektorin ICT dhe që kanë në fokus zgjerimin në tregje të reja dhe krijimin e partneriteteve.

Në ditën e parë u zhvilluan ‘study tour’ në bizneset ICT në Kosovë, si raste suksesi. Gjatë ditës së dytë u vijua me takime #B2B mes biznesve me qëllim shkëmbimin e eksperiencave në sektorin e ICT, si dhe për të krijuar bashkëpunime dhe partneritete.



AIDA DHE EEN-ALBANIA PJESË E EVENTIT NË QYTETIN E PËRMETIT PËR FUQIZIMIN E GRUAS SIPËRMARRËSE

Dhoma Ekonomike e Gruas zhvilloi në qytetin e Përmetit aktivitetin me temë: "Fuqizimi i gruas sipërmarrëse në ekonomi dhe vendimmarrje". Aktiviteti mbledhi bashkë përfaqësuese gra të bizneseve të qytetit të Përmetit, për të diskutuar mbi fuqizimin e pozitës së gruas për të bërë biznes, si dhe krijimin e mundësive për financim.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar edhe përfaqësues të AIDA-s dhe EEN-Albania, ku mbajtën një prezantim mbi shërbimet dhe mundësitë që AIDA dhe EEN-Albania ofrojnë për gratë sipërmarrëse që duan të zhvillohen në tregje të reja, të përmirësojnë konkurrencën, të zhvillojnë inovacionin dhe të rrisin konkurrueshmërinë në tregun evropian e më gjerë.



HISTORI SUKSESI EEN-ALBANIA & AIDA

“Life on a boat”- një biznes nën drejtimin e një sipërmarrëse të re

Stafi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Enterprise Europe Network- Albania (EEN-Albania) zhvilluan një vizitë pranë ambienteve të biznesit “Life on a boat”.

“Life on a boat” është një biznes familjar që merret me prodhimin e mjeteve lundruese prej druri të të gjitha kapaciteteve dhe ofron për tregun vendas dhe të huaj, modele të ndryshme varkash.

Ndërlidhja e kulturës detare dhe traditës së ndërtimit të mjeteve lundruese është sjellë në mënyrë unike për të gjithë brezat sot.



Biznesi “Life on a boat” menaxhohet nga Genta, një sipërmarrëse e re, por tashmë e njohur kudo si vajza që ndërton varka druri. Në vitin 2019 nëpërmjet bashkëpunimit dhe suportit të AIDA-s dhe EEN-Albania, kompania arriti të krijojë kontakte të reja dhe marrëveshje partneriteti me kompani në shtetin e Malit të Zi.

WEBINAR – TAKIME ONLINE



SI TË HARTONI PROFILIN E BIZNESIT TUAJ - HAPI I PARË DREJT TREGUT EUROPIAN

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Enterprise Europe Network-Albania, organizuan webinarin me temë: Si të hartoni profilin e biznesit tuaj hapi i parë drejt tregut evropian. Webinarin u mbajt për sipërmarrjet shqiptare me ambicie për të qenë pjesë e tregut evropian me qëllim informimin mbi mënyrën se si hartohet një profil biznesi, si një hap i parë dhe i rëndësishëm për t'u bërë pjesë e tregut evropian dhe për të zgjeruar aktivitetin në tregun ndërkombëtar.


Znj. Lorina Salaj, eksperte e SME-ve pranë AIDA-s, gjatë prezantimit bëri një përshkrim të shkurtër të Rrjetit Europian të Ndërmarrjeve, si rrjeti më i madh në botë në mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme për të qenë pjesë e tregut botëror dhe që targeton 17 sektorë kyç të veprimtarisë ekonomike. Gjithashtu, publikimi i profileve të biznesit në databazën e të dhënave të Rrjetit është një mundësi shumë e mirë për krijimin e marrëveshjeve të suksesshme të partneritetit.



PREZANTOHET DRITARJA UNIKE “AKSES NË FINANCË”

Mbahet online takimi prezantues i dritares unike “Akses në Financë”. Kjo platformë është një instrument elektronik që i dedikohet të gjitha Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare që kanë nevojë për financim, në mënyrë që të marrin në kohë reale të gjithë informacioni mbi skemat financiare që ofrohet nga instucione shtetërore apo donatorë. Platforma ka për qëllim të ndihmojë sipërmarrjet shqiptare, të cilat duan të zgjerojnë dhe investojnë në aktivitetin e tyre duke

përtuar nga mundësitë financiare që tregu ofron, me grante, kredi ose nisma të tjera financuese. Në takimin prezantues mbajtën fjalën e tyre: Zëvendësminisri i Financave dhe Ekonomisë, z. Besart Kadia; Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano dhe Përfaqësuesja e BERZH, znj. Endrita Xhaferraj. Platforma <https://aida-smefinance.gov.al/> menaxhohet nga AIDA dhe synon të kthehet në portën unike, për t'u njohur me gjithë skemat e financimit që kanë si target-grup Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme shqiptare. Platforma u mundësua me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe bashkëpunimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).



AIDA NË TAKIMIN E PËRBASHKËT ME AGJENCITË E PROMOVIMIT TË INVESTIMEVE NGA IRLANDA, KOSTA RIKA & KAMBOXHIA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në takimin e përbashkët që u zhvillua me agjencitë e huaja të promovimit të investimeve, ku u përfaqësua nga Drejtoria e Investimeve. Një takimi virtual që u organizua nga International Trade Center (ITC), në bashkëpunim me German Development Institute (DIE), World Association of Investment Promotion Agencies (WAIPA) dhe World Economic Forum (WEF) dhe ishte pjesë e një serie eventesh virtuale me temë “Forcimi i kapacitetit të lehtësimit të investimeve me synim zhvillimin”. Agjencitë e zhvillimit të investimeve nga Irlanda, Kosta Rika dhe Kamboxhia ndanë përvojën e tyre në lehtësimin e investimeve, përmes databazave të furnitorëve dhe kontakteve. Mbajta e këtij webinarit kishte si fokus të ndihmojë agjencitë e promovimit të investimeve si dhe politikëbërësit, në funksion të forcimit të kapacitetit të tyre, për të mundur flukse më të mëdha të IHD-ve, veçanërisht prurjet e investimeve që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillim.



International
Trade
Centre

AIDA NË KONFERENCËN RAJONALE “WESTERN BALKANS LABOR MARKET’S REVIEW”

AIDA mori pjesë në konferencën rajonale “Western Balkans Labor Market’s Review”-Regional Talk ToWard EU Accession. Në kuadër të bisedimeve rajonale për aderimin në BE, EastEuroCo Executive Research Group organizoi konferencën me temë “Western Balkans Labor Market’s Review”. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të agjencive homologe të investimit nga Shqipëria, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, si edhe përfaqësues të Bordit Ekonomik të

Vienës, Parlamentit të Kosovës, Dhomës së Tregtisë Hungareze etj. Gjatë 3 sesioneve të mbajtura, u diskutua mbi: zhvillimet e fundit në tregun e punës; mundësitë e investimit në shtetet përkatëse; eksperiencën e investitorëve në këto shtete.

Përfaqësues të Drejtorisë së Investimeve të AIDA-s, prezantuan mundësitë e investimeve, incentivat specifike mbi sektorët prioritarë në Shqipëri, historitë e suksesit dhe eksperiencat e investitorëve më të rëndësishëm, të cilët janë asistuar nga AIDA, përgjatë realizimit të projekteve të tyre të investimit.



SFIDAT E INOVACIONIT NË SIPËRMARRJE - TAKIME ME AKTORË

Përfaqësues të AIDA-s ishin pjesë e takimit virtual të organizuar nga Këshilli i Investimeve mbi “Sfidat e Inovacionit në Sipërmarrje”. Prioriteti i rekomandimeve dhe stimulimi i debatit mbi përsheptimin e axhendës kombëtare mbi inovacionin në sipërmarrje, konkludoi pas analizës dhe konsultimit të gjerë me mbi 40 aktorë (sipërmarrës, institucione publike, universitete, organizma ndërkombëtare, institucione financiare, eksperte të pavarur etj.). Bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirja mbetet parakusht për një proces konsultimi e dialog gjithëpërfshirës, të qendrueshëm dhe transparent.



RUBRIKA | WEBSITE



PLATFORMA “BUSINESS TO BUSINESS”

Në web faqen e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është e publikuar platforma “Business to Business”, (B2B) që ju vjen në ndihmë NVM që veprojnë në Shqipëri.

B2B është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve.

Kjo platformë është një “mekanizëm” lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit.

AIDA, ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B, duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

Për t’u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

PLATFORMA BUSINESS TO BUSINESS

RUBRIKA COVID-19

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) si pasojë e situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, për t’ju ardhur në ndihmë bizneseve vazhdon të përditësojë me informacionet më të fundit rubrikën “COVID-19”.

Në të publikohen iniciativat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për të përballuar situatën, informacionet më të reja në lidhje me paketat financiare në ndihmë të biznesit, aplikimet për programet e mbështetjes së biznesit, projektet, nismat e tjera publike, si edhe lidhje e kontakte të rëndësishme.

Rubrika ka si qëllim aksesin dhe qarkullimin e informacioneve më të rëndësishme, në një kohë sa më të shpejtë, për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t’u njohur me publikimet më të fundit në këtë rubrikë vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/covid-19/>



COVID-19

SHQIPËRIA NË EXPO 2020 DUBAI, KRAH 190 SHTETEVE TË TJERA PJESËMARRËSE

Nga 1 tetor 2021 deri më 31 mars 2022, në Emiratet e Bashkuara Arabe, do të mbahet Expo 2020 Dubai. Përfaqësimi i vendit në një panair botëror të këtyre përmasave përbën një ngjarje me rëndësi të veçantë.

Shqipëria në Expo do ketë pavijonin e vet, i cili do jetë i vendosur në zonën e Lëvizshmërisë (Mobility). Mobility, një hapësirë që krijon dhe prezanton ura lidhëse fizike dhe virtuale për lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe ideve, duke siguruar qasje më të lehtë në tregje, njohuri dhe inovacion.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në faqen web ka krijuar një rubrikë të posaçme dedikuar pjesëmarrjes së Shqipërisë në Expo 2020 Dubai: <https://www.aida.gov.al/sq/expo-2020-dubai-uae>



PËRRALLA PËR FËMIJË NGA E GJITHË BOTA, NË KUADËR TË EXPO 2020 DUBAI

Në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në EXPO 2020 DUBAI, AIDA u kujdes që Shqipëria të bëhet pjesë e nismës për të krijuar një libër ndërkombëtar përrallash, duke dhënë kontributin me përrallën shqiptare “E bija e hënës dhe e diellit” dhe ilustrimet shoqëruese të saj. Përralla e Mitrush Kutelit “E bija e hënës dhe e diellit”, botuar në librin “Tregime të moçme shqiptare”, është një ritregim magjepsës i autorit, frymëzuar prej krijimtarisë popullore. Tregimtarë dhe artistë të talentuar, nga e gjithë bota, janë bërë bashkë për të qenë pjesë e nismës dhe për të krijuar këtë koleksion argëtues dhe të larmishëm me përralla. Përrallat e prezantuara në këtë koleksion pasqyrojnë frymën e angazhimit dhe janë një mënyrë argëtuese për fëmijët që duan të eksplorojnë ide dhe kultura të reja. AIDA, fton të gjithë lexuesit fëmijë, të njihen me përrallën shqiptare “E bija e hënës dhe e diellit”, si edhe të eksplorojnë këtë koleksion shumëngjyrësh dhe frymëzues të përrallave nga e gjithë bota. Për të lexuar përrallën shqiptare klikoni linkun:

https://aida.gov.al/images/PDF/Childrens_Tales_From_Around_The_World-435-447.pdf

Për të lexuar përrallat e koleksionit nga e gjithë bota klikoni linkun:

<https://schools.expo2020dubai.com/ar/initiatives-for-schools/childrens-tales-from-around-the-world>






PËRDITËSIME DHE INFORMACIONE

EDICIONI I 7-TË PËR ÇMIMET 'ITU DIGITAL WORLD 2021'

AIDA njoftoi se Sekretariati i Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) ka hapur aplikimet për edicionin e 7-të për çmimet 'ITU Digital World 2021'. Ftohen të marrin pjesë NVM-të me zgjidhje inovative të bazuar në Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit/TIK për sfida socio-ekonomike - kudo në botë, në një nga 5 kategorit: Lidhshmëri-zgjidhje inovative për rritjen e aksesit universal në internet. Qytete 'smart', jetë e zgjuar- përdorimi i teknologjisë digjitale për të përmirësuar jetën urbane dhe më gjerë. E-shëndetësia-përmirësimi i kujdesit shëndetësor përmes risive teknologjike. Financa digjitale-nisma të bazuara në TIK për të përmirësuar aksesin në ekonomi. EdTech, teknologji arsimore-mjete inovative për të zgjeruar programet arsimore.



ÇELET EDICIONI I PARË I DITËVE INFORMUESE HORIZON EUROPE

AIDA njoftoi se do të zhvillohen 'Horizon Europe Info Days'. Ngjarja 10-ditore do u japë mundësi aplikantëve të ardhshëm, palëve të hulumtimit dhe inovacionit të BE-së, për të marrë informacione dhe shtruar pyetje në lidhje me instrumentet kryesore të financimit në Horizon Europe. 'Horizon Europe Info Days' do të trajtojnë 9 tema, secila me një program diskutimesh ekskluziv dhe seancash praktike.



SETTING UP OF A BIG PUBLIC BUYERS NETWORK FOR STRATEGIC PUBLIC PROCUREMENT, NGA PROGRAMI COSME

AIDA njoftoi mbi hapjen e thirrjes për tender 'Setting up of a Big Public Buyers network for strategic public procurement', nga programi #COSME. Objektivi kryesor i kësaj thirrjeje për tender është të përmirësojë mjedisin e biznesit të NVM-ve inovative dhe ta bëjë prokurimin publik një mundësi tërheqëse për operatorët ekonomikë, përmes një përvetësimi të zgjeruar të prokurimit publik strategjik në Evropë. Me qëllim nxitjen e tregut për mallra, shërbime dhe punë inovative, do të promovohen bashkëpunime midis blerësve të



mëdhenj në prokurimin publik strategjik. Ky program, i cili vijon nga "Big Buyers and Networks Initiative" në 2019, synon të kontribuojë në rimëkëmbjen ekonomike të BE-së, duke stimuluar inovacionin dhe fillestarët. Zgjerimi i rrjetit të blerësve publik të mëdhenj në të gjithë BE-në do të rrisë ndikimin e blerësve publik në mjedisin e biznesit të operatorëve ekonomikë në një mënyrë të ekuilibruar. Në të njëjtën kohë, kërkohet të përfshihen lloje të ndryshme të blerësve publikë: ministri ose agjenci kombëtare, spitale, rajone, qytete, organe publike, kompani që i nënshtrohen prokurimit publik, etj.

THIRRJA ENHANCING DIGITAL AND ENTREPRENEURIAL COMPETENCES IN GIRLS AND WOMEN, NGA PROGRAMI COSME

AIDA njoftoi mbi thirrjen 'Enhancing Digital and Entrepreneurial Competences in Girls and Women', nga programi COSME. Gratë sipërmarrëse mbështetën me rrjetëzimin dhe këshillat e biznesit përmes platformës online WEgate dhe grupit të EEN për gratë, të gjitha të financuara përmes programit COSME. Për të rritur aftësitë digjitale dhe sipërmarrëse dhe për të rritur besimin e vajzave dhe grave, veprimet që duhet të zbatohen duhet të krijojnë një mjedis ku këto aftësi mund të mësohen përmes përvojës.

Pjesëmarrësit së pari duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre të tilla, si: ndërtimi i ndërmarrjes, shkrim-leximi financiar, kodimi, dizenjimi i mjeteve digjitale, robotikë etj. Zhvillimi i këtyre aftësive do të zhvillohet në një hapësirë studimi e cila do të quhet 'Tech Fest'. Fokusi i thirrjes është të përfshijë një numër sa më të lartë të vajzave dhe grave në zhvillimin e aftësive të tyre konkurruese, novatore dhe digjitale.

PROGRAMI COSME ÇELI 'EUROPEAN CLUSTER COLLABORATION PLATFORM'


AIDA njoftoi për çeljen e 'European Cluster Collaboration Platform' nga programi COSME. Qëllimi i këtij programi është të promovojë zhvillimin e klasterave në Europë, me synimin për të nxitur konkurrencën, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e burimeve të NVM-ve. Fokusi është në lidhjen më të mirë të grupeve dhe ekosistemeve në të gjithë Europën në mënyrë që të përshpejtohet modernizimi industrial dhe lehtësimi i bashkëpunimit më strategjik ndërrajonal.

Programi jo vetëm që do të vazhdojë të hartojë dhe profilizojë më shumë se 500 organizata të klasterave dhe ekosistemet e tyre në të gjithë Europën për të lehtësuar krijimin e rrjeteve, por gjithashtu do të mbështesë përpjekjet e bashkëpunimit midis organizatave dhe #NVM-ve. 'European Cluster Collaboration Platform' krijon mundësi për t'u angazhuar në bashkëpunimin strategjik ndërrajonal, përmes mbështetjes së lidhjeve midis palëve të interesuara për të marrë asistencë teknike për zhvillimin e projekteve të përbashkëta bashkëpunuese me partnerë ndërkombëtarë.

ÇMIMI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR GRATË INOVATORE/EU PRIZE FOR WOMEN INNOVATORS


AIDA njoftoi se Komisioni Evropian ka hapur thirrjen për aplikime ~"Çmimi i Bashkimit Evropian për Gratë Inovatore/EU Prize for Women Innovators". Çmimi i BE-së u jepet grave dhe vajzave sipërmarrëse, të talentuara, nga e gjithë BE-ja dhe vendet e lidhura me programin Horizon Europe, të cilat kanë themeluar një kompani të suksesshme dhe kanë sjellë risi në treg. Çmimi menaxhohet nga Këshilli Evropian i Inovacionit dhe Agjencia Ekzekutive e NVM-ve, ku fituesit do të

zgjidhen nga një juri e pavarur ekspertësh. Në kategorinë kryesore të 'Grave Inovatore', do ndahen tre çmime prej 100 000 euro secila, që sipas jurisë, kanë shkëlqyer në të gjitha kriteret dhe kanë spikatur ndërmjet aplikantëve të tjerë. BE synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për potencialin, rëndësinë dhe kontributin e grave në ekosistemin e inovacionit, si dhe të krijojë modele frymëzuese në këtë fushë dhe jashtë saj.



ÇMIMI I VITIT NË ALBANIAN ICT AWARDS 9

AIDA njoftoi për thirrjen e Albanian ICT Awards, edicionin e nëntë. Mund të aplikojë çdo shtetas shqiptar, i cili ka qenë bartës i së paku një projekti të suksesshëm përgjatë vitit kalendarik 2020-2021. Kriter për t'u konsideruar kandidat i suksesshëm apo i nominuar, mund të jetë çdokush që përmes teknologjisë arrin të demonstrojë rezultate të matshme dhe të prekshme aty ku është e mundur, që paraqet zhvillimin e një teknologjie të re, apo përdorimin e një teknologjie ekzistuese me metoda të reja. Fituesit e këtij edicioni do të kenë mundësinë e shpërblimeve të shumta, si: bursa studimi, trajnime dhe rrjetëzim me investitorë potencialë.




AKADEMIA E GRAVE SIPËRMARRËSE NË SHQIPËRI

AIDA informoi se janë hapur aplikimet për t'u bërë pjesë e Akademisë për Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri/Academy for Women Entrepreneurs in Albania, për vitin 2021. Ky është viti i i dytë i zbatimit dhe lançimit të kësaj nisme në vendin tonë. Vjen si një program që mbështetet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në bashkëpunim me Qendrën Ideo dhe Destil Creative Hub. AWE-2021 synon të ndihmojë gratë të sjellin në jetë idetë e tyre sipërmarrëse.



AIDA BASHKËPUNIM ME PROJEKTIN PËR PROMOVIMIN E POLITIKAVE TË INVESTIMIT NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR (WB IPP)

Banka Botërore nëpërmjet Projektit për Promovimin e Politikave të Investimit në vendet e Ballkanit Perëndimor (WB IPP) synon krijimin e një hapësire dinamike për investime në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedonia e Veriut, Kosovë, Mali i Zi, Serbi) përmes identifikimit dhe heqjes së barrierave ndërkufitare dhe krijimit të investimeve brenda rajonit. Duke nxitur një harmonizim mes politikave rajonale të investimeve dhe përafrimin me standardet e BE-së, projekti synon të krijojë nivele më të larta të investimeve të huaja direkte dhe investimeve ndërrajonale, rritje më të shpejtë ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në rajon. Për arritjen e objektivave, projekti ka një bashkëpunim të ngushtë me Agjencitë e Promovimit të Investimeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6), ndër të cilat edhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).



Ndiqni videon në vijim dhe informohuni mbi kontributin dhe suportin e Projektit për Promovimin e Politikave të Investimit në vendet e Ballkanit Perëndimor (WB IPP): <https://www.facebook.com/investinalbania/posts/165139088952822>



BOTIME

AIDA PUBLIKON “ZGJIDH TË VENDIT” KATALOGU I PARË I PRODUKTEVE “MADE IN ALBANIA”

#eduashqip, nisi prej muajit korrik 2020 si një fushatë që promovon produktet #MadeinAlbania. Një nismë e veçantë e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve e domosdoshme për Shqipërinë, për markën e vendit dhe ndërmarrjet shqiptare. Si botim i parë, katalogu “Zgjidh të Vendit”, për periudhën korrik-dhjetor 2020, prezanton 45 kompani, ku kryeson sektori i prodhimit të verës, i ndjekur nga artizanati dhe agropërpunimi.

AIDA në një përpjekje për një retrospektivë modeste rreth produkteve me origjinë shqiptare, në një rubrikë të veçantë, bëri pjesë të katalogut “Zgjidh të Vendit” disa nga brendet që u shndëruan në simbole dhe madje i rezistuan kohës. Për pak histori, nostalgji, për të risjellë edhe kulturën e markave autentike, sidomos të prodhimeve që datojnë para viteve ‘90, AIDA në katalogun e parë të “Zgjidh të vendit”- zgjedh karamela ‘Zana’, cigare ‘Lux’, birra ‘Korça’, konjak ‘Skënderbeu’.



Katalogu mund të shfletohet online, në web faqen e AIDA-s, linku:

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/832-katalogu-i-pare-i-produkteve-made-in-albania>

BROSHURAT MË TË REJA TË AIDA-S



‘SEKTORI I TEKSTILEVE’

‘Sektori i Tekstileve’ -Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të sektorit të tekstitil në Shqipëri, statistika të viteve të fundit, sfidat kryesore të sektorit pas periudhës së pandemisë, si edhe informacione mbi avantazhet dhe rëndësinë e sektorit në ekonomi.

Kliko linkun: <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/944-sektori-i-tekstileve>



‘SEKTORI I LËKURËS DHE KËPUCËS’

‘Sektori i Lëkurës dhe Këpucës’ - Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të sektorit të lëkurës dhe këpucës në Shqipëri, statistika të viteve të fundit, proceset e punës, produktet dhe shërbimet kryesore, informacione mbi mbështetjen e sektorit nga shteti dhe AIDA, si edhe rëndësinë e sektorit në ekonomi.

Kliko linkun: <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/947-sektori-i-lekures-dhe-kepuces>



“SEKTORI I TIK”

“Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (Tik)” - Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Shqipëri, statistika të viteve të fundit, proceset e punës, produktet dhe shërbimet kryesore, si edhe informacione mbi mbështetjen e sektorit nga shteti dhe AIDA.

Kliko linkun: <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1003-sektori-i-tik>



“OPTIMIZIMI I INVESTIMEVE NË AGROPËRPUNIM” PËRGATITUR NGA KËSHILLI I INVESTIMEVE

Botimi synon të promovojë dhe sjellë sektorin e agropërpunimit në vëmendjen e vendimmarrësve apo investitorëve, për rritjen e fokusit në produktet vendase dhe markës #MadeinAlbania. Përmban informacione, për: incentivat kryesore të drejtpërdrejta dhe masat mbështetëse në lidhje me sektorët e bujqësisë/agropërpunimit; investimet strategjike në agrobiznes; skedë/kartë teknologjike për përpunimin e salcës së domateve. Botimin e gjeni online në faqen web të AIDA-s, në rubrikën Publikime. Kliko linkun: <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/833-optimizimi-i-investimeve-ne-agro-perpunim>

STATISTIKA



EKSPORTET REKORD HISTORIK

EKSPORTET
REKORD HISTORIK

109
MILIARDË LEKË

JANAR - PRILL 2021



AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

✉ info@aida.gov.al

🌐 aida.gov.al

☎ +355 (0)42 251 001

🐦 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

📷 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

📘 AIDA - Albanian Investment Development Agency

🌐 AIDA - Albanian Investment Development Agency